



Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a.

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur
31 Dhjetor 2010**

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e gjendjes financiare	3
Pasqyra e të ardhurave të përgjithshme	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7 – 37

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo

T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Manaxhmentin dhe Aksionarët e
Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të **Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.a.** (tutje referuar si ‘Kompania’), e cila përbëhet nga Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2010, dhe Pasqyra gjithëpërfshirëse e të hyrave, Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese, të përfshira në faqet 3 deri 37.

Përgjegjësia e manaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe kontrollat e tilla siç i përcakton menaxhmenti është e nevojshme të mundësojnë përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoft si pasoj e mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësi e jona është të shprehim një mendim në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi drejtuar auditimin tonë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike, planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë procedura të kryerjes së punës për të marrë dëshmi lidhur me auditimin për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Procedurat e zgjedhura varen nga vlerësimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm relevant në përgatitjet dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të dizajnojnë procedura të auditimit që janë të duhurat në rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimit kontabël të bërë nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm për pasqyrat financiare.

Ne besojmë që dëshmitë që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për një opinion të auditimit tonë.

Mendim

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare prezentojnë drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Kompanisë deri më 31 Dhjetor 2010, dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Theksim i çështjes

Pa kualifikime të mëturjeshme në mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen për çështjet në vijim:

Siq është shpalosur në Shënimin 4 të pasqyrave financiare burimi kyç i vlerësimit të menaxhmentit në mënyrë të pasigurtë lidhet me riparueshmërinë e llogarive bankare dhe depozitave të vendosura me Bankën Kreditore të Prishtinës Sh.a., gjithashtu dhe mungesa e matjes së duhur dhe ndikimi potencial financiar nga pasiguria e pronësisë lidhur me interesat në toka dhe ndërtesa të përdorura në aktivitete biznesore të Kompanisë.

Për më tepër dhe siq është shpjeguar në Shënimin 4 Kompania lidhet me thirrjet fikse ndërkombëtare të administruar nga jashtë nëpërmjet linjave të menaxhuara nga Telekom Serbia. Përderisa nuk ka një marrëveshje ndërlidhse në mes të PTK-së dhe Telekom Serbia që do të mund të rregullonte lidhjet e përbashkëta për sa i përket trafikut të telekomunikacionit efekti financiar i trafikut ndërlidhës nuk mund të matet dhe përcaktohet në mënyrë të besueshme.

Siq është shpalosur në Shënimin 4 të pasqyrave financiare për datën e pozicionit financiar çështje të rëndësishme të pronësisë ekzistojnë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillim të administrimit të Kosovës nga KB-ja, dhe mungesa e matjes dhe përcaktimit të besueshëm të ndikimit potencial financiar.


Grant Thornton,

Prishtinë,
10 Qershor 2011

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Bilanci i Gjendjes

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010


(në mijë Euro)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Asetet			
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	114,471	123,078
Asetet e patrupëzuara	6	15,916	14,383
Investime ne pjesëmarrje	7	-	2,400
Asetet financiare te disponueshme për shitje	8	240	-
Investimet afatgjata financiare	13	58	10,586
Pasuria e tatimit te shtyrë	9	1,655	2,564
Totali i aseteve jo-qarkulluese		132,340	153,011
Asetet Qarkulluese			
Stoqet	10	6,885	8,692
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	11	15,311	18,766
Tatimi në fitim i arkëtueshëm	23	793	3,646
Shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera	12	5,018	4,627
Investimet afatshkurtra financiare	13	2,138	50,019
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	13	45,195	25,181
Totali i aseteve qarkulluese		75,340	110,931
Totali i aseteve		207,680	263,942
EKUITETI			
Kapitali i emetuar	14	5,000	5,000
Premi e aksionarit		55,000	55,000
Fitimet e mbajtura		132,207	178,811
Totali i Ekuitetit		192,207	238,811
Detyrimet			
Llogaritë e pagueshme tregtare	15	6,991	15,863
Akrualet dhe të pagueshmet tjera	16	6,063	6,342
Të ardhurat e shtyera	17	2,419	2,926
Totali i detyrimeve Qarkulluese		15,473	25,131
Totali i Detyrimeve		15,473	25,131
Totali i Ekuitetit dhe detyrimeve		207,680	263,942

Bilanci i gjendjes duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 37 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Bordi i drejtoreshë i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.a ka autorizuar lëshimin e këtyre pasqyrave financiare më 09 Qershor 2011. Këto janë të nënshkruara nga:

Rexhë Gjonbalaj
Kryetar i Bordit



Dr. Shyqyri Haxha
Kryeshf Ekzekutiv



Nuredin Krasniqi
Kryetar Kryesor i Financave dhe Thesarit



Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Pasqyra e të ardhurave të përgjithshme

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro)

	Shëni me	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Të ardhurat	18	151,503	145,030
Të ardhurat e tjera	19	482	50
Shpenzimet operacionale	20	(26,047)	(25,164)
Shpenzimet e stafit	21	(47,271)	(40,583)
Zhvlerësimi	5	(17,547)	(16,155)
Amortizimi	6	(7,146)	(6,579)
Humbja nga dëmtimi i bilanceve bankare	13	10	1,249
Shpenzimet tjera	22	(18,382)	(19,737)
Të hyrat e interesit	13	2,054	11,454
Fitimi përpara tatimit		37,656	49,565
Shpenzimi i tatimit në fitim	23	(4,260)	(5,188)
Fitimi neto për vitin		33,396	44,377
Të ardhura të tjera të përgjithshme për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të përgjithshme për vitin		33,396	44,377

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 37 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave të financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet

Për 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro)

	Shënime	Kapitali i Emetuar	Premi e aksionarit	Fitimi i mbartur	Totali
Bilanci me 1 janar 2010		5,000	55,000	178,811	238,811
Transaksionet me pronarin					
Dividendë		-	-	(80,000)	(80,000)
Total transaksionet me pronarin		-	-	(80,000)	(80,000)
Fitimi për vitin		-	-	33,396	33,396
Të ardhura tjera të përgjithshme		-	-	-	-
Totali i të ardhurave tjera të përgjithshme		-	-	33,396	33,396
Bilanci me 31 Dhjetor 2010		5,000	55,000	132,207	192,207
Bilanci me 1 Janar 2009		260,000	-	134,434	394,434
Transaksionet me pronarin					
Zvogëlimi i ekuitetit sipas vendimit të Qeverisë	2.15,13	(255,000)	55,000	200,000	-
Dividentat		-	-	(200,000)	(200,000)
Total transaksionet me pronarin		(255,000)	55,000	-	(200,000)
Fitimi për vitin		-	-	44,377	44,377
Të ardhura tjera të përgjithshme		-	-	-	-
Të ardhura tjera të përgjithshme		-	-	44,377	44,377
Bilanci me 31 Dhjetor 2009		5,000	55,000	178,811	238,811

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 37 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

	Shënim	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi për periudhën		33,396	44,377
<i>Rregulluar për:</i>			
Zhvlerësimin	5	17,547	16,155
Amortizimin	6	7,146	6,579
Asetet financiare te disponueshme për shitje	8	(240)	-
Humbjet/(kthimet) e dëmtimit në vlerë – borxhet e dyshimta	11	1,686	1,594
Humbjet/(kthimet) e dëmtimit në vlerë – depozitat bankare	13	(10)	(1,249)
Të hyrat e interesit	13	(2,054)	(11,454)
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim	23	3,351	4,764
Shpenzimi/(të hyrat) e tatimit të shtyrë (Humbjet) e njohura në ekuitet	9	909	424
		-	-
		61,731	61,190
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues dhe provizione			
Garanci dalje për Monaco Telecom International		-	-
Ndryshimet në stoqe		1,807	(3,676)
Ndryshimet në llogaritë e të arkëtueshmeve tregtare		1,769	(2,533)
Ndryshimet në shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera		(391)	(3,784)
Ndryshimet në llogaritë e të pagueshmeve		(8,872)	8,756
Ndryshimet në akruale dhe të pagueshme tjera		(279)	(1,476)
Ndryshimet në të ardhurat e shtyera		(507)	392
		55,258	58,869
Paratë e gjeneruara nga operimet			
Tatimi në fitim i paguar		(498)	(5,302)
Pagesat për taksat dhe tatimet tjera		-	-
Dividendat e paguara		(80,000)	(200,000)
		(25,240)	(146,433)
Rrjedha parasë nga aktivitetet			
Interes i arkëtuar		1,725	14,412
Investime ne bashkëpjesëmarrje		2,400	(2,400)
Pagesat për blerjen e tokës, impianteve dhe pajisjeve		(8,940)	(24,785)
Blerja e pasurive të patrupëzuara		(8,679)	(5,301)
Investimet neto në depozitat bankare		58,748	110,557
		45,254	92,483
Paratë neto të gjeneruara nga/(përdorura në) aktivitetet investuese			
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalente të parasë		20,014	(53,950)
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 janar		25,181	79,131
	13	45,195	25,181

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 37 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

1. HYRJE

E përgjithshme

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. ("Kompania") është një shoqëri aksionare e korporatizuar në Republikën e Kosovës. Selia kryesore e kompanisë është e vendosur në Dardani, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aktivitetet e biznesit të kompanisë përbëjnë ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit, të telefonisë mobile dhe fikse, shërbimeve postare dhe shërbimeve të internetit.

Më 31 dhjetor 2010, Kompania ka 3,384 punonjës (2009: 3,205).

Informata mbi operimin e kompanisë

Ndërmarrja PTK ka qenë një ndërmarrje sipas kuptimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 "Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit". Rregullorja 2005/18 i ka dhënë AKM-së autoritetin për të transformuar ndërmarrjet në korporata. Në takimin e datës 9 maj 2005, Bordi i Drejtorëve i AKM-së ka vendosur të transformojë ndërmarrjen PTK në shoqëri aksionare, të quajtur Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a. Në datën e korporatizimit më 22 qershor 2005, PTK holding në mënyre efektive zëvendëson "ndërmarrjen" e mëparshme që kryente biznes në mënyre formale si "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës" në baza vazhdimësie, pa likuidim. Ndërmarrja PTK është ndërmarrja e parë që është transformuar në Korporatë nën rregulloren e AKM-së dhe Udhëzimin Administrativ 2005/6. AKM-ja, që vepron si administrator i besuar për pronarët kryesor të ndërmarrjeve të Kosovës bazuar në rregulloren e AKM-së, është aksionari aktual i 100% të aksioneve të PTK Holding. Kapitali i emtuar aksionar në korporatizim shënon 260 milion Euro.

Menjëherë pas korporatizimit. PTK Holding ka formuar një Grup operativ, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a. ("PTK") dhe ka transferuar disa nga pasuritë e saj tek PTK në formë të kontributit kapital. PTK Holding ka në pronësi 100% të PTK-së.

Kapitali i regjistruar i vartësit të zotëruar në tërësi është 250 milion Euro, dhe aksionet e vartësit janë emtuar në këmbim për asetet e caktuara neto të kontribuara nga PTK Holding. Duke pasur parasysh efektin praktik të transformimit dhe korporatizimit, Administrata Tatimore ka aprovuar procesin ristrukturues të ndërmarrjes PTK-së si një "riorganizim" për qëllime të Nenit 24.1. të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave".

Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Ndërmarrjet Publike (ligji Nr.03/L-087), dhe në bazë të dispozitave të nenit 3 të këtij ligji, ndërmarrjet qendrore në pronësi publike, duke përfshirë PTK sh.a., janë deklaruar si pasuri e Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e aksionarëve mbi Ndërmarrjet Publike.

Më 13 tetor 2009, Qeveria ka nxjerrë vendimin për shkrirjen e këtyre dy kompanive, PTK Holding dhe PTK Sh.A., në Postë Telekomunikacionin e Kosovës Sh.A. ("Kompania") me kapital të regjistruar prej 5.000.000 Euro, i përbërë nga pesë milionë aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1 euro për aksion. Të gjitha aksionet janë lëshuar në emër të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet biznesore

Më 31 Dhjetor 2010, kompania ka tri njësi biznesore, dy nga të cilat janë të licensuara nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit në Kosovë ("ART"), njera është e autorizuar nga ART që të ofrojë shërbime interneti dhe një prej tyre është gjithashtu e licensuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit:

Njësia Postare ("Posta")

Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës ("BPK") i ka lëshuar PTK-së licencën financiare jobankare e cila i mundëson Postës ofrimin e pagesave në para të gatshme dhe faturimin për palëve të treta. Ndërsa më 15 maj 2006, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit i ka lëshuar PTK-së licencën për ofrimin e shërbimeve postare universale.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

1. HYRJJE (vazhdim)

Njësia e Telefonisë Fikse ("Telefonia Fikse")

Njësia e Telefonisë Fikse është i vetmi ofruar i licencuar i shërbimeve të telefonisë fikse për konsumatorët individual dhe të biznesit në territorin e Kosovës. Njësia e telefonisë fikse gjithashtu ka ofruar shërbime të internetit që nga viti 2001, dhe ajo sot është një nga tre operatorët e autorizuar nga ART-ja, që ofrojnë shërbime të internetit në Kosovë.

Njësia e telefonisë ("Vala 900")

Vala 900 është njësia operuese e telefonisë mobile GSM dhe aktualisht është njëri nga dy rrjetet e licencuara dhe ofruar i shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë.

Ndërmarrja e PTK-së në vitin 2000 arriti një marrëveshje me "Monaco Telecom International" ("MTI") për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë ku kjo marrëveshje i jep të drejtë PTK-së të përdorë kodin internacional të MTI-së, i cili i mundëson rrjetit mobil të PTK-së lidhje me rrjetet ndërkombëtare. Si element i kësaj marrëveshjeje, PTK-ja i kompenson MTI-së një pjesë të të hyrave dhe pagesë të disa shpenzimeve të trafikut ndërkombëtar. Gjatë vitit 2006, kontrata ndërmjet MTI dhe PTK SH.A. ishte rinegociuar dhe ndryshuar. Kontrata e re kornizë përfshin përdorimin e kodit të thirrjeve të Monaco International, trafikun ndërkombëtar, roaming dhe transferimin njohurive teknike, e cila marreveshje hyn ne fuqi 1 Janar 2010. Përveç kësaj, kontrata kornizë përfshinte edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve.

Poashtu në Maj të vitit 2009, kontrata ndërmjet MTI dhe PTK Sh.a. ishte ri-negociuar dhe ndryshuar. Aneksi i kontratës e re kornizë përfshin përdorimin e kodit të thirrjeve të Monako Internacional, trafikun ndërkombëtar, roaming dhe transferimin njohurive teknike, e cila ka hyr ne fuqi nga 1 Janari 2010.

Përveç kësaj, Aneksi i kontratës se re kornizë përfshin edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve si dhe zvogëlim te tarifave për kodin.

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjeve të përcaktuara me SNRF për secilin lloj të pasurisë, të përgjegjësisë, të ardhurave e shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të plotë në politikat e kontabilitetit më poshtë.

2.3 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në euro, që është monedha/valuta funksionale PTK-së. Të gjitha informatat financiare të raportuara në euro, janë rrumbullakuar në mijëshen me të përafërt.

2.4 Përdorimi i vlersimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave të kontabilitetit dhe shumat e raportuara të aseteve, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë rishikuar vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në ndonjë periudhë pasuese që preket nga ato. Veçanërisht, informacioni mbi fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit që kanë ndikimin më të madh në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4–Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)
2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Politikat e kontabilitetit të paraqitura në vazhdim janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në vazhdimësi nga PTK Sh.a.

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe audituar për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009.

2.5 Ndryshimet në politikat kontabël dhe deklarinimet

- (a) Standardet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Kompania

Standardet e reja të mëposhtme dhe ndryshimet në standardet janë të detyrueshme për herë të parë për vitin financiar filluar më 1 janar 2010:

SNRF 3 (i rishikuar), "Kombinimet e biznesit", dhe ndryshimet kryesore në SNK 27, "Pasqyrat e konsoliduara dhe të veçanta financiare", SNK 28, "Investimet në bashkëpunëtorët" dhe SNK 31, "Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta" janë të efektshme në mënyrë prospektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është më ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 korrikut 2009.

Standardi i rishikuar vazhdon të aplikojë metodën e blerjes për kombinimet e biznesit, por me disa ndryshime të rëndësishme në krahasim me SNRF 3. Për shembull, të gjitha pagesat për blerjen e një biznesi janë të regjistruara me vlerën e drejtë në datën e blerjes, me pagesat e kontingjentit të klasifikuara si borxh më pas i ri-matur me anë të pasqyrës së të ardhurave. Ekziston një zgjedhje në bazën blerje me blerje për të matur interes jo-kontrollues në të marrë ose me vlerën e drejtë ose në pjesën proporcionale të interesit jo-kontrollues të neto mjeteve të blerësit. Të gjitha kostot e blerjes janë të shpenzuara.

Pasi që Kompania ka miratuar IFRS 3 (i rishikuar), është e nevojshme për të miratuar SNK 27 (i rishikuar), "pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të veçanta", në të njëjtën kohë. SNK 27 (i rishikuar) kërkon që efektet e të gjitha transaksioneve me interesat jo të kontrolluara të jenë të regjistruara në kapitalin e vet në qoftë se nuk ka ndryshim në kontroll dhe këto transaksione nuk do të rezultojnë në vullnetin e mirë ose fitimet dhe humbjet. Standardi gjithashtu e specifikon kontabilitetin kur kontrolli është i humbur. Ndonjë interes i mbetur në entitet është i ri-matur me vlerën e drejtë, dhe një fitim ose humbje është e njohur në fitim ose humbje.

Në vitin aktual, Kompania nuk ka transaksione të lidhura me kombinimet e biznesit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.5 Ndryshimet në politikat kontabël dhe deklarimet (vazhdim)

(b) Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e detyrueshme për herë të parë për vitin financiar me fillim më 1 Janar 2010, por aktualisht nuk janë relevante.

Standardet në vazhdim, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë botuar dhe janë të detyrueshme për periudhat e kontabilitetit të kompanisë duke filluar më ose pas 1 janarit 2009 ose më vonë, por që nuk janë aktualit relevante për Kompaninë.

IFRIC 9, 'Rivlerësimi i derivateve të mbjellura dhe SNK 39, Instrumentet financiare: Njohja dhe matja', duke filluar nga 1 korriku 2009. Ky amendament në IFRIC 9 kërkon një entitet që të vlerëson nëse një derivat i përfshirë duhet të jetë i ndarë nga kontrata kur subjekti e riklasifikon një mjet hibrid financiar jashtë "vlerës së drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes". Ky vlerësim duhet të bëhet në bazë të rrethanave që ekzistonin më vonë nga data kur subjekti për herë të parë u bë palë e kontratës dhe datën e çdo amendamenti të kontratës që në mënyrë të konsiderueshme ndryshon rrjedhën e parasë në kontratë. Nëse subjekti nuk është në gjendje që të bëjë këtë vlerësim, instrumenti hibrid duhet të mbetet i klasifikuar sipas vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes në tërësinë e saj. Kjo aktualisht nuk është e aplikueshme për Kompaninë, pasi që nuk ka vendosur derivatet si pasuri financiare hibride.

KIRFN 16, "Mbrotjtja e një investimi neto në një operacion të huaj", duke filluar nga 1 korriku 2009. Ky amendament tregon që, në mbrotjtje të një neto investimi në një operacion të huaj, instrumentet e kualifikuara të mbrotjtjes mund të mbahen nga çdo subjekt brenda grupit, duke përfshirë edhe vet operacionin e huaj, për aq kohë sa përcaktimi, dokumentacioni dhe kërkesat e efektivitetit të SNK 39 që kanë të bëjnë me një mbrotjtje neto të investimeve, janë të kënaqura. Në veçanti, grupi duhet të dokumentojë qartë strategjinë e tij të mbrotjtjes për shkak të mundësisë së përcaktimeve të ndryshme në nivele të ndryshme të grupit. SNK 38 (ndryshim), 'mjetet e paprekshme', duke filluar nga 1 janar 2010. Amendamenti sqaron udhëzime në matjen e vlerës së drejtë të një mjeti të paprekshëm të siguruar në një kombinim biznesi dhe lejon grupimin e mjeteve të paprekura në një mjet të veçantë nëse çdo pasuri/mjet ka jetën e ngjashme dobishme ekonomike. Kjo nuk është relevante në Kompani, pasi që nuk ka mbrotjtje nga një neto investimi në një operacion të huaj.

IFRIC 17, "Shpërndarja e aseteve jo në para të gatshme për pronarët", në fuqi për periudhat vjetore duke filluar më apo pas 1 korrikut 2009. Kjo nuk është aktualisht e aplikueshme për Kompaninë, pasi që ajo nuk ka marr bërë ndonjë shpërndarje jo-monetare.

IFRIC 18, "Transferimi i aseteve nga konsumatorët", efektive për transferimin e aseteve të marra më ose pas 1 korrikut 2009. Kjo nuk është e rëndësishme për Kompaninë, pasi që nuk ka marrë asnjë nga asetet nga konsumatorët.

"Përrjashtimet shtesë për adoptuesit për herë të parë" (ndryshim nga SNRF 1) është lëshuar në korrik 2009. Ndryshimet janë të nevojshme që të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2010. Kjo nuk është e relevante për Kompaninë.

SNK 36 (ndryshim), "Dëmtimi i aseteve", duke filluar nga 1 janari 2010. Amendamenti sqaron se njësia më e madhe e gjenerimit të mjeteve monetare (ose grup i njësive), për të cilën duhet të caktohet vullneti i mireë për qëllime të testimit të dëmtimit, është një segment operativ, siç është përcaktuar nga paragrafi 5 i SNRF 8, "Segmentet operative" (që është, para grumbullimit të segmenteve me karakteristikat e ngjashme ekonomike).

SNRF 2 (ndryshimet), "Grupi i transaksionit të pagesave të vendosura në para të gatshme dhe të bazuara në aksione", në fuqi prej 1 janarit 2010. Përveç inkorporimit të IFRIC 8, 'fushëveprimi i SNRF 2' dhe KIRFN 11, 'SNRF 2 – Transaksionet e aksioneve të thesarit', ndryshimet e zgjeruara në udhëzimin e IFRIC 11 për të adresuar klasifikimin e marrëveshjeve të grupit që nuk ishin të mbuluara nga ky interpretim.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.5 Ndryshimet në politikat kontabël dhe deklarimet (vazhdim)

(b) Standardet, interpretimet dhe amendamentet në standardet e nxjerra efektive për vitin financiar duke filluar më 1 janar 2010 por dhe por aktualisht nuk është relevante (vazhdon):

SNRF 5 (ndryshim), 'Pasuritë jo të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera'. Sqarimet e amendamentit që SNRF 5 specifikon dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara në lidhje me mjetet jo aktuale (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuara si të mbajtura për shitje ose operacionet e ndërprera. Ai gjithashtu sqaron se kërkesa e përgjithshme e SNK 1 ende zbatohet, në veçanti paragrafi 15 (për të arritur një paraqitje të drejtë) dhe paragrafi 125 (burimet e një vlerësimi të pasigurt) të SNK 1.

- **Përmirësimet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 2009** janë nxjerrë në prill 2009. Datat efektive ndryshojnë nga standardi në standard, por shumica janë efektive që nga 1 janari 2010.

(c) *Standardet, interpretimet dhe amendamentet në standardet e nxjerra por jo efektive për vitin financiar duke filluar më 1 janar 2010 dhe jo më heret e adoptuar nga Kompania:*

SNRF 9, "Instrumentet Financiare", të nxjerra në dhjetor 2009. Kjo i drejtohet klasifikimit dhe matjes së asetëve financiare dhe ka gjasa të ndikojë në kontabilitetin e Kompanisë për asetet financiare. Standardi nuk është i zbatueshëm deri në 1 janar 2013, por është në dispozicion për miratim të hershëm. Kompania ende ka për ta vlerësuar ndikimin e plotë e SNRF 9. Kompania nuk ka vendosur ende se kur do të miratojë SNRF 9.

SNK 24 i rishikuar, "Deklarimet e partive të ngjashme", të lëshuara në nëntor 2009. Kjo e zëvendëson SNK 24, "Deklarimet e partive të ngjashme", të lëshuara në vitin 2003. SNK 24 e rishikuar është e nevojshme që të aplikohet nga 1 janari 2011. Aplikimi më herët është i lejuar.

"Klasifikimi i çështjeve e të drejtave" (ndryshimet në SNK 32), lëshuar në Tetor 2009. Për çështjet e të drejtave të ofruara nga një sasi e caktuar të valutës së huaj, praktika e tanishme duket të kërkojë çështje të tilla që të trajtohen si detyrime derivateve. Amendamenti thekson se në qoftë se ato të drejtat janë të lëshuara pro rata për të gjithë aksionarët ekzistues në të njëjtën klasë për një sasi të caktuar të monedhës, ata duhet të klasifikohen si kapital, pavarësisht të monedhës në të cilën çmimi i ushtrimit është i shprehur. Amendamenti duhet të zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë me datën 1 shkurt 2010. Zbatimi i mëhershëm është i lejuar.

"Parapagimet e një kërkesë minimale financimi" (ndryshimet në IFRIC 14), të lëshuar në nëntor 2009. Ndryshimet e korrigojnë një pasojë të paqëllimshme të IFRIC 14, "SNK 19-limiti mbi një pasuri të përfitimeve të përcaktuara, kërkesat minimale të financimit dhe bashkëveprimi i tyre". Pa ndryshime, subjektet nuk janë të lejuara që të njohin si një aset disa nga parapagimet për kontribute vullnetare për fonde minimale. Kjo nuk ishte e planifikuara kur është lëshuar KIRFN 14, dhe ndryshimet e kanë korrigjuar problemin. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011. Zbatimi i mëhershëm është i lejuar. Ndryshimet duhet të aplikohen në mënyrë retrospektive në periudhën e krahasuar të paraqitur sa më herët.

IFRIC 19, "Detyrimet e shuara financiare me instrumentet kapitale". Kjo sqaron kërkesat e SNRF-ve, kur një njësi / subjekt ri-negocion për kushtet e një detyrimi financiar me kreditorin tij dhe kur kreditori pajtohet që të pranon aksionet e subjektit ose instrumentet e tjera kapitale për të shlyer detyrimin financiar plotësisht ose pjesërisht. Interpretimi është në fuqi për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 korrik 2010. zbatimi i mëhershëm është i lejuar.

Përmirësimet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 2010 janë lëshuar në maj 2010. Datat efektive dallojnë prej standardit në standard, por shumica janë në fuqi që nga 1 korriku 2010.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.6 Valuta e huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit që është në datat e transaksioneve. Asetet monetare dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit janë kthyer përsëri në valutën funksionale me normën e këmbimit në atë datë. Fitimi dhe humbja e valutës së huaj mbi zërat monetar është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutën e huaj të kthyer në normën e këmbimit në fund të periudhës. Asetet jo-monetare dhe detyrimet në valuta të huaja që janë matur në vlerë reale janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera reale. Ndryshimet e valutës së huaj që dalin nga kthimet janë njohur në fitim apo humbje, përveç për diferencat që dalin nga rikthimi i instrumenteve të ekuitetit të gatshme për shitje (nëse ka).

2.7 Prona, impiantet dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë matur në kosto (ose kosto të vlerësuar) minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë. Disa artikuj të pronës, impianteve dhe pajisjeve që janë rivlerësuar më 1 janar 2005. datë e kalimit tek SNRF-të, me vlerë reale në lidhje me korporatizimin e filluar të PTK Holding, janë matur në bazë të kostos së vlerësuar, duke qenë shumica e rivlerësuar në datën e atij rivlerësimi.

Kostoja përshinë shpenzimet që janë direkt të ngarkuara në blerje të asetit. Kostoja e asetëve të vetëndërtuara përfshinë koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që është direkt e ngarkuar në sjelljen e asetit në gjendje punë për qëllimin e menduar, dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së artikullit dhe rregullimin e vendit ku janë vendosur. Shpenzimet kapitale mbi asetet gjatë ndërtimit janë bartur tek Asetet në ndërtim dhe janë kapitalizuar e transferuar në kategorinë e duhur të asetit atëherë kur përfundohen, prej ku fillon aplikimi i zhvlerësimit në normën e aplikueshme ndaj kategorisë në fjalë.

Kur pjesët e një artikulli të pronës, impianteve dhe pajisjeve kanë kohë të ndryshme të përdorimit, ato janë regjistruar si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

(ii) Kostot pasuese

Kostoja e zëvendësimit së një pjesë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është njohur në vlerën bartëse të artikullit nëse është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tyre të mund të matet me besueshmëri. Kostot e serviseve të përditshme të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë njohur në fitim apo humbje atëherë kur kanë ndodhur.

Fitimet apo humbjet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë përcaktuar duke u referuar në vlerën e tyre bartëse dhe janë marrë parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi është njohur në fitim apo humbje në bazë lineare përgjatë kohës së vlerësuar të përdorimit të secilës pjesë të një artikulli të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Toka dhe pasuritë në ndërtim nuk janë zhvlerësuar. Kohët e vlerësuar të përdorimit për klasat madhore të pasurive janë si në vazhdim (si për vitin 2009 edhe 2008):

- | | |
|--|----------------|
| • Ndërtesat (nga data e vlerësimit) | 20 vite |
| • Zyrat postare (strukturë druri) | 10 vite |
| • Linjat e rrjetit | 20 vite |
| • Kanalet kablloviqe dhe shtyllat e antenave | 20 vite |
| • Stacionet Bazë | 5 vite |
| • Makineria dhe pajisjet | 5 deri 10 vite |

Kohët e përdorimit, metodat e zhvlerësimit dhe vlerat e mbetura, nëse kanë qenë të rëndësishme, të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë ripasqyruar në datën e raportimit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.8 Asetet e patrupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Asetet e patrupëzuara janë matur në kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi i akumuluar në vlerë, nëse ka.

(ii) Shpenzimet pasuese

Shpenzimi pasues është kapitalizuar vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në asetin specifik me të cilin ndërlidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për zërin e mirë dhe brendet e gjeneruara në mënyrë interne, është njohur në fitim dhe humbje kur ka ndodhur.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë kohës së vlerësuar të përdorimit të aseteve të patrupëzuara nga data kur ato janë të gatshme për përdorim. Kohët e vlerësuara të përdorimit janë në vazhdim (për vitin 2009 dhe 2008):

- Programet kompjuterike 5 vite
- Liçensat e telekomit 15 vite

2.9 Rënia në vlerë e aseteve jo-financiare

Prona, ndërtesat e pajisjet, si dhe asetet e patrupëzuara, janë shqyrtuar për rënie në vlerë sa herë që ngjarje të ndryshmeve, në rrethana të caktuara, tregojnë se shuma bartëse e një pasurie nuk mund të jetë e rikuperueshme. Kurdo që shuma bartëse e një pasurie e tejkalon shumën e vet të rikuperueshme, humbjet nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Shuma e rikuperueshme është më e lartë se çmimi neto i shitjes së një pasurie dhe vlerës në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e arritshme nga shitja e një pasurie në transaksion të plotë, ndërsa vlera në përdorim është vlera aktuale e fluksit të parave të gatshme e parashikuar në të ardhmen që pritet të rrjedhin nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe heqja e saj në fund të përdorimit. Shumat e rikuperueshme janë llogaritur për asetin individual, ose, nëse nuk është e mundur, për njësinë që gjeneron para të gatshme.

2.10 Investimet e përbashkëta

Investimet e përbashkëta janë ato investime ku kompania ka ndikim të rëndësishëm dhe që nuk është degë, dhe as ndërmarrje e përbashkët e kompanisë. Ndikimi i rëndësishëm është ndërmjet 20% dhe 50% të të drejtës së votes në kompani. Investimet e përbashkëta njihen në pasqyrat financiare të kompanisë si kosto.

2.11 Pasuritë financiare

Kompania klasifikon pasuritë e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: kredi dhe të arkëtueshme dhe në asete financiare në dispozicion për shitje. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare.

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë mjetet financiare që mbahen për tregtim. Një aset financiar është klasifikuar në këtë kategori nëse merret kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë të klasifikuara si asete aktuale. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori në datat e raportimit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.11 Pasuritë financiare (vazhdim)

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo të prejardhura, me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të maturimeve më të mëdha se 12 muaj pas datës së bilancit. Kreditë/huatë dhe të arkëtueshmet e kompanisë, në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, si dhe paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parave të gatshme.

Asetet financiare në dispozicion për shitje

Asetet financiare në dispozicion për shitje janë jo të prejardhura, që, ose janë caktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në asnjë nga kategoritë e tjera. Ato janë të përfshira në asetet jo-qarkulluese deri sa menaxhmenti nuk synon të heqë dorë nga investimi brenda 12 muajve nga data e bilancit të gjendjes.

Blerjet dhe shitjet e asetëve financiare janë të njohura në datën e tregtimit - datën në të cilën kompania angazhohet për të blerë ose shitur asetin përkatës.

Të gjitha asetet financiare, përveç asetëve në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit.

Asetet financiare që janë në dispozicion për shitje pastaj janë bartur me vlerën e drejtë. Huatë dhe të arkëtueshmet janë bartur sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë monetare dhe jo-monetare të klasifikuara si në dispozicion për shitje janë njohur në ekuitet/kapital.

Kur letrat me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje janë shitur ose kanë rënë në vlerë, rregullimet në vlerën e drejtë të akumuluar të njohura në ekuitet janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme si fitime dhe humbje nga letrat me vlerë të investimeve.

Interesi në letrat me vlerë që janë në dispozicion për shitje, i llogaritur duke përdorur metodën efektive të interesit, njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividendët për instrumentet e kapitalit në dispozicion për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme si pjesë e të ardhurave të tjera, kur është themeluar e drejta e Kompanisë për të marrë pagesat.

Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar janë të bazuara në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një aset financiar nuk është aktiv (dhe për letrat me vlerë jo të listuara), Kompania vendos vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Në rast të investimeve në dispozicion për shitje, rënia e ndjeshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të asetëve nën koston e tyre, konsiderohet në përcaktimin nëse asetet kanë rënë në vlerë. Nëse ekziston ndonjë dëshmi e tillë për asetet financiare në dispozicion, humbja kumulative – e matur si diferenca mes kostos së blerjes dhe vlerës aktuale të drejtë, më ndonjë humbje nga rënia në vlerë e asetit financiar që më parë është njohur në fitim ose humbje - është hequr nga ekuiteti dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme mbi instrumentet e kapitalit nuk janë të ndryshuara përmes pasqyrës së të ardhurave. Analizimi i rënies në vlerë i të arkëtueshmeve tregtare është përshkruar në këtë Shënim 2.13.

2.12 Inventari

Inventari është dhënë në koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostoja përfshin shpenzimin e shkaktuar në blerjen e inventarit dhe sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese.

Kostoja e inventarit të konsumuar është bazuar në formulën e mesatares së ponderuar.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.13 Të arkëtueshme tregtare (vazhdim)

Të arkëtueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, më pak provizion për rënie në vlerë. Një dispozitë për rënie në vlerë të arkëtueshmet tregtare është krijuar, kur ka prova objektive se kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë ose të të ndërmarrë riorganizim financiar, dhe mosplotësim të zotimeve ose shkelje ligjore në pagesat (më shumë se 30 ditë nga kalimi i afatit) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare kanë rënë në vlerë

Shuma e provizionit është diferenca në mes të shumës që mbante aset dhe vlerës aktuale të fluksit të parasë të parashikuar në të ardhmen, të zbritura në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me një maturim të shkurtër nuk janë zbritur. Vlera e mbartur e asetit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie kompensimi, dhe shuma e humbjes është e njohur në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme. Kur një e arkëtueshme tregtare nuk mund të mblidhet, ajo është zbritur kundrejt llogarisë së kompensimit për të arkëtueshmet tregtare. Rikuperimet pasuese të shumave zbritura më parë janë të njohura si të ardhura rrjedhese në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme.

2.14 Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankat dhe investimet e tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitetet origjinale prej tre muajsh ose më pak.

2.15 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar dhe të ardhurat e mbajtura

(i) Kapitali i aksionarëve

Kapitali aksionar paraqet vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(ii) Kostot e emetimit të aksioneve

Shpenzimet shtesë drejtpërdrejtë të lidhura me emetimin e aksioneve të reja, me opsionet ose me profitin e një biznesi, janë prezantuar si zbritje neto e tatimeve nga këto zhvillime.

(iii) Aksionet e thesarit

Kur Kompania e blen kapitalin aksionar, shuma e paguar është e zbritur nga totali i kapitalit të 'aksionarëve' si aksionet e thesarit deri sa të anulohen. Kur aksionet e tilla më pas shiten apo emetohen serish, çdo konsideratë e marrë është përfshirë në kapitalin e aksionarëve.

(iv) Të ardhurat e mbajtura

Të ardhurat e mbajtura përbëhen nga të ardhurat jo të shpërndara në periudhat aktuale dhe të kaluara.

2.16 Te pagueshmet tregtare

Të pagueshmet tregtare janë vlerësuar në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas janë matur me koston e tyre të amortizuar duke aplikuar metodën e normës efektive të interesit.

2.17 Përfitimet e të punësuarve

Pensionet e detyrueshme

Kompania, përgjatë rrjedhës normale të biznesit, kryen pagesa në emër të tij dhe në emër të të punësuarve të tij për të kontribuar në pensionin e detyrueshëm në pajtueshmëri me legjislacionin vendor. Kostot e pësuar në emër të Kompanisë janë ngarkuar në fitim dhe humbje kur kanë ndodhur.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

Përfitimet e të punësuarve (vazhdim)

Përfitimet afatshkurtra

Obligimet e përfitimeve afatshkurtra të punonjësve janë matur në bazë jo-të skontueshme dhe janë shpenzuar pasi që shërbimi i ndërlidhur të jetë ofruar. Provizioni është njohur për shumën që pritet të paguhet sipas bonusi afatshkurtër në para nëse Kompania ka një obligim të tanishëm ligjor apo të tërthortë për të paguar shumën si rezultat i shërbime të ofruara në të kaluarën nga punonjësi dhe obligimi të mund të vlerësohet me besueshmëri.

2.18 Provizionet

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Kompania ka obligim të tanishëm apo të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të nevojitet një rrjedhje e parasë në ardhmen për të shlyer obligimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar rrjedhat e pritshme të parasë në të ardhmen me normën përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë si dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit.

2.19 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga telefonia mobile

Të ardhurat nga shërbimet e telefonisë mobile nga kartat parapaguese me gërvishtje dhe Sim kartat janë njohur duke u bazur në përdorim. Koha e pashfrytëzuar për bisedë është përfshirë në "Të hyrat e shtyera" në Pasqyrën e gjendjes financiare. Pas skadimit të kartave gërvishtëse me parapagim, koha e mbetur e pashfrytëzuar është njohur si e hyrë.

Të ardhurat nga komunikimi me kontratë (post paid) janë njohur duke u bazur në kohën aktuale të gjeneruar të bisedës nga telefonuesi në periudhën aktuale.

Të ardhurat nga roamingu ndërkombëtar (international roaming air time) janë njohur në bazë të minutave të shfrytëzuar në pajtueshmëri me raportet periodike financiare të ofruara nga ofruesi i shërbimit të rrjetit, Monaco Telecom International.

Të ardhurat nga linja fikse

Të ardhurat nga linja fikse janë njohur në bazë të minutave të ndërlidhur me periudhën aktuale.

Të ardhurat nga shërbimi i internetit

Të ardhurat nga shërbimet e internetit janë njohur në bazë lineare përgjatë periudhës së abonimit të konsumatorit.

Të ardhurat tjera

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë njohur në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme kur rreziqet e rëndësishme dhe shpërblimet e pronësisë i janë transferuar blerësit. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara janë njohur në pasqyrën e të ardhurave në proporcion me fazën e kompletimit të transaksionit në datën e bilancit të gjendjes.

2.20 Shpenzimet

Komisioni i detyruar ndaj Monaco Telecom International

Kostot e komisionit ndaj Monaco Telecom International janë njohur në bazë akruale kur kanë ndodhur.

Pagesat e qerasë operacionale

Pagesat e kryera nën qeranë operacionale janë njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qerasë. Stimujt e pranuar të qerasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qerasë, përgjatë afatit të qerasë.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.21 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi fondet e investuara në depozita bankare, fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve financiare të gatshme për shitje, dhe fitimet e njohur në huaj. Të ardhurat e interesit janë njohur si parashikim aktual, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet e valutës së huaj, lëshimet e skontimit të provizioneve, nëse janë materiale, dhe humbjet e dëmtimit në vlerë të njohura në asetet financiare.

2.22 Dhënia e dividendës

Dhënia e dividendës aksionarëve të Kompanisë është e njohur si detyrim në pasqyrat financiare në periudhën e miratuar nga aksionaret e kompanisë

2.23 Shpenzimi i tatimit në fitim

Shpenzimi i tatimit në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit në fitim është njohur në fitim dhe humbje përveç rasteve që ndërlidhen me artikujt e njohur direkt në ekuitet, ku në atë rast edhe tatimit është njohur në ekuitet. Aktualisht, tatimi i pagueshëm është kalkuluar dhe paguar në përputhje me Ligjin Nr 03/L-162 mbi të ardhurat e korporatave, që ka që ka hyrë në fuqi nga 1 janari 2010. Tatimi përfundimtar mbi fitimin në normën prej 10% bazohet mbi fitimin e axhustuar (fitimi vjetor i prezantuar në pasqyrën e të ardhurave pas rregullimit të shpenzimeve (shpenzimet e pazbritshme, shpenzimet e përjashtuara, rregullimit të zhvlerësimit)). Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet tatimore mund të barten brenda një periudhe prej shtatë vite, pas vitit në të cilin humbje tatimore u lind, mirëpo bëhen disa përjashtime, atëherë kur kemi bartje mbi 50% të pronësisë dhe ndërrim të aktivitetit. Tatimi i shtyrë është njohur duke përdorur metodën e bilancit të gjendjes, duke sjellë diferencë të përkohshme ndërmjet vlerave bartëse të aseteve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë nuk është njohur për diferencat e përkohshme në vazhdim: njohja fillestare e zërit të mirë, njohja fillestare e aseteve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim i biznesit dhe që nuk ka ndikim as në kontabilitet as në fitim të tatueshëm, dhe diferencat në lidhje me investimet në entitete vartëse dhe me kontroll të përbashkët deri aty ku ato ka mundësi që nuk do të kthehen në të ardhmen e parashikuar. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë në fuqi në datën e raportimit. Aseti i tatimit të shtyrë është njohur kur është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Asetet e tatimit të shtyrë janë rishikuar në secilën datë të raportimit dhe janë reduktuar ashtu që nuk është e mundur më tej që përfitimi i ndërlidhur tatimor të realizohet.

2.24 Raportimet segmentuese

Kompania operon plotësisht në territorin e Kosovës që identifikohet si një segment i vetëm gjeografik. Për më tepër, të dhënat në dispozicion mbi segmentet e ndryshme të biznesit janë paraqitur në shënimin 17: Të hyrat operative.

2.25 Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike brenda Kompanisë është e mundur. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka mundësi që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, një detyrim i pësuar në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.26 Palët e ndërlidhura

Palët e lidhura janë ato palë, ku njëri nga palët është e kontrolluar nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palës tjetër.

2.27 Ngjarjet pasuese pas datës së raportimit Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë mbi pozicionin e Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënime kur kanë qenë materiale.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010 (në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

3.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë riskun e monedhës, riskun e vlerës së drejtë të interesit, riskun e normës së interesit nga rrjedhja e parasë dhe riskun e çmimeve), riskun e kredive dhe riskun e likuiditetit. Programi për menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut të kompanisë përqendrohet tek paparashikueshmëria e tregjeve financiare dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të kompanisë.

Ky shënim paraqet informata rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të lartpërmendura, objektivat e Kompanisë, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimi i kapitalit nga ana e Kompanisë. Përshkrime të mëtejshme sasiore janë përfshirë në këto pasqyra financiare.

Menaxhmenti ka përgjegjësi të përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e kornizës së kompanisë për menaxhimin e rrezikut. Politikat e kompanisë për menaxhimin e rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Kompania, për të përcaktuar kufijtë dhe kontrollet përkatëse të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe përmbajtjen ndaj kufizimeve. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e rrezikut shqyrtohen në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet në treg dhe kushte legjislative si dhe aktivitetet e kompanisë.

3.2 Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare të Kompanisë nëse konsumatori ose pala e kundërt ndaj një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e obligimeve kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet e Kompanisë nga konsumatori dhe investimet në depozita bankare.

Të arkëtueshmet tregtare

Kompania ka themeluar një kompensim të dëmit që përfaqëson vlerësimin e saj për humbjet e shkaktuara në lidhje me tregtinë dhe arkëtimet e tjera dhe investimet. Elementet kryesore të këtij kompensimi janë një komponentë kolektive e krijuar për klientët e ngjashëm në lidhje me humbjet që janë shkaktuar por ende nuk janë identifikuar. Kompensimi për humbjen kolektive është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për mjetet e ngjashme financiare.

Investimet në depozita bankare

Kompania ka llogari të konsiderueshme rrjedhëse edhe investuese në të gjitha institucionet bankare në Kosovë.

Garancitë

Politika e Kompanisë është që të ofrojë garanci financiare vetëm me vendim të drejtorëve të autorizuar apo personelit kyç të menaxhmentit.

Procesi i menaxhimit të riskut të kredisë nga aktivitetet operative përfshin masa parandaluese siç janë kontrollimi i kreditibilitetit dhe parandalimit, masat korrigjuese gjatë marrëdhënies juridike për shembull aktivitetet e rikujtimit dhe shkyçjeve, bashkëpunimi me agjencitë e mbledhjes dhe grumbullimit pas marrëdhënies ligjore siç janë procesi gjyqësor, procedura gjyqësore, përfshirja e njësisë së ekzekutivit dhe faktorizimit. Pagesat e mbetura janë përcjellë me një procedurë të përshkallëzuar të borxhit në bazë të llojit të konsumatorit, klasës së kreditit dhe shumës së borxhit. Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është përfaqësuar nga shuma bartëse e çdo aseti financiar në pasqyrën e gjendjes financiare të përmbledhur më poshtë:

	2010	2009
Kategoritë e aseteve financiare – shumat ngritëse:		
Asete financiare të disponueshme për shitje	240	-
Të arkëtueshme financiare	2,196	60,605
Të arkëtueshme tregtare	15,311	18,766
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	45,195	25,181
	62,942	104,552

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)
3.2 Risku i kredisë (vazhdim)

Risku i kreditit për para të gatshme dhe ekuivalentet në para konsiderohen të papërfillshme, pasi që palët homologe janë banka me reputacion me cilësi të lartë të normave të kreditit të jashtëm.

Struktura e moshës e të ardhurave të tregtisë është si vijon:

	2010	2010	2010	2009	2009	2009
	Shuma bruto	Dëmi	Shuma neto	Shuma bruto	Dëmi	Shuma neto
Jo nga e kaluara						
Deri në 30 ditë	7,470	164	7,306	5,942	-	5,942
Nga 1-3 muaj	4,998	268	4,730	4,457	225	4,232
Nga 3-6 muaj	2,226	359	1,867	4,769	474	4,295
Nga 6-12 muaj	1,589	846	743	3,757	1,828	1,929
Mbi 1 vit	39,154	38,489	665	36,986	34,618	2,368
	55,437	40,126	15,311	55,911	(37,145)	18,766

Nga 31 Dhjetor 2010, cilësia e kredisë së të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë është si në vijim:

	As nga e kaluara, as e zhvlerësuar	Nga e kaluara por jo e zhvlerësuar	Zhvlerësuar	Total
Shuma ngritëse	7,470	7,841	40,126	55,437
Provizioni i zhvlerësimit	-	-	(40,126)	(40,126)
	7,470	7,841	-	15,311

3.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit definohet si risku që Kompania nuk mund të jetë në gjendje ta zgjidhë, ose të përmbushë detyrimet e saj në kohë.

Politika e Kompanisë është që të mbajë para të gatshme, dhe ekuivalentet në para, të mjaftueshme për të përmbushur angazhimet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Sektori i Financave po përgatit parashikimin e rrjedhës së parasë për kërkesat e likuiditetit, për të siguruar se ka para të mjaftueshme për të plotësuar nevojat operacionale në çdo kohë. Parashikimi merr parasysh planet e Kompanisë për financimin e borxheve dhe pajtueshmërinë me objektivat e përpjesëtimit të gjendjes së bilancit. Çdo para e gatshme (kesh) tepricë e mbajtur nga Kompania mbi bilancin e kërkuara për nevojat e kapitalit të punës, zakonisht është depozituar në bankat komerciale apo investuar në letrat me vlerë të tregtueshme.

Tabela e mëposhtme analizon detyrimet financiare të kompanisë në grupimet përkatëse të maturimit, të bazuara në periudhën e mbetur në gjendjen e bilancit deri në datën kontraktuale të maturimit. Bilancet për t'u paguar brenda 12 muajve, barazohen me bilancet e tyre të mbartura pasi që ndikimi i zhvlerësimit nuk është i rëndësishëm. Pjesë e madhe e të pagueshmeve të tregtisë ka maturim brenda një viti.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
 (në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)
3.3 Risku i likuiditetit (vazhdim)

	Më pak se 1 vit	Në mes të 1 dhe 2 viteve	Në mes të 2 dhe 5 viteve	Mbi 5 Vite
Më 31 dhjetor 2010				
Të pagueshme tregtare dhe tjera	6,991	-	-	-
Total	6,991	-	-	-

	Më pak se 1 vit	Në mes të 1 dhe 2 viteve	Në mes të 2 dhe 5 viteve	Mbi 5 vite
Më 31 dhjetor 2009				
Të pagueshme tregtare dhe tjera	15,863	-	-	-
Total	15,863	-	-	-

3.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku se ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si kursi i këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e ekuitetit do të ndikojnë në të hyrat e Kompanisë ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektiva e menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj këtij rreziku përbrenda parametrave të pranuar, duke e optimalizuar kthimin.

Risku i këmbimit të jashtëm

Si një e tërë, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës, sepse:

- të ardhurat fitohen në Euro
- blerjet e aseteve kryesore dhe materialeve të përdorura në aktivitetet e investimeve të Kompanisë janë të shfaqura në Euro
- asetet financiare janë të emërtuara në Euro.

Risku i çmimit

Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut të letrave me vlerë të kapitalit të çmimeve për shkak të investimeve të mbajtura (të klasifikuara në gjendjen e bilancit si të gatshme për shitje), të cilat mund të preken nga ndryshoret e rrezikut të tilla si çmimet e bursës.

Rrjedhja e parasë dhe rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit

Norma e rrezikut të interesit është rreziku se vlera e drejtë e rrjedhave të ardhshme të parave të gatshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i kompanisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me detyrimet e borxheve afat-gjatë të kompanisë me normë lëvizëse interesi. Huazimet e marra nga kompania me normat e ndryshueshme e të interesit ekspozojnë kompaninë ndaj rrishtit të normave të interesit.

Kompania analizon ekspozimin e normës së interesit në një bazë dinamike. Skenarë të ndryshëm janë konsideruar, duke marrë parasysh përtëritjen e pozicioneve ekzistuese, ri-financimit dhe financimit alternativ.

Rreziku i interesit është menaxhuar me diversifikimin e mbështetjes së kredive nga disa banka me kushtet e ndryshme të financimit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)

3.4 Rreziku i tregut (vazhdim)

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e kompanisë ndaj rrezikut të normës së interesit.

	2010	2009
Asetet		
<u>Mbajtja pa interes:</u>		
Asetet financiare te disponueshme për shitje	240	-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare (me përjashtim të tatimeve të paguara)	15,311	18,766
Paratë e gatshme	683	643
	16,234	19,409
Me norma fikse të interesit:		
Llogaritë e arkëtueshme financiare	2,196	60,605
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	44,512	24,538
	46,708	85,143
	62,942	104,552
Detyrimet		
<u>Mbajtja pa interes:</u>		
Llogaritë e pagueshme tregtare (me përjashtim të aktualeve dhe tatimeve të pagueshme)	6,991	15,863
	6,991	15,863

Rreziku nga normat e interesit

Llogaritë e depozitave bankare të PTK-së fitojnë interes me përqindje të caktuar komerciale në datën e kontratës përkatëse dhe janë të maturura sipas datave fikse. Kompania nuk ka huazime me kamatë as në 2010 as në 2009.

3.5 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Politika e menaxhimit është të mbajë një bazë të fortë kapitale në mënyrë që të ruajë besimin e tregut dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen.

Për shkak të kufizimeve të jashtme të vendosura nga mjedisi (p.sh. pamundësi që të vendosen depozitat jashtë vendit, proceset e gjata të prokurimit, etj.) menaxhmenti i kompanisë nuk mund të zbatojë një menaxhim efikas të kapitalit të veçantë për ekonomitë e liberalizuara.

Nuk ka pasur ndryshime në qasjen e Kompanisë në menaxhimin e kapitalit gjatë vitit.

Kompania nuk është subjekt i kërkesave kapitale të imponuara në mënyrë kontraktuale apo ligjore.

Kompania e monitoron kapitalin në bazë të normës së ingranimit (përpjesëtimin).

3.6 Vlerësimi i drejtë i vlerës

Vlera e drejtë paraqet shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim i vendosur në bazë të gjerë. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet e manaxhmentit sipas profilit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)

3.6.1 Instrumentet financiare të paraqitura në vlerën e drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e gjendjes financiare, në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë janë prezantuar në tabelën e ardhshme. Kjo hierarki grupon mjetet dhe detyrimet financiare në tri nivele, që janë të bazuara mbi rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia sipas vlerës reale përcaktohet si vijon:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për mjetet identike ose detyrimet;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera hyrëse, përveç çmimet e cituara, të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë në dispozicion për vrojtimin e asetit ose detyrimit, drejtpërdrejt (dmth. si çmimet), ose në mënyrë indirekte (dmth. të përcaktuara nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi asetin ose detyrimin, që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për hulumtimin e tregut.

Asetet financiare, që janë të regjistruara në përputhje me vlerat e tyre të drejta në pasqyrën e gjendjes financiare, janë të grupuara sipas shkallës së hierarkisë të vlerës së drejtë, si vijon:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Total
Asetet				
<u>Asetet financiare të disponueshme për shitje</u>	-	240	-	240

Asetet financiare të disponueshme për shitje përmbajnë pjesëmarrjen në kapitalin e subjekteve vendase dhe të huaja ligjore. Ata janë të matura në përputhje me vlerën e drejtë në bazë të vlerës së tyre të tregut në datën e pasqyrës së gjendjes financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
 (në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)

3.6.2 Instrumentet financiare që nuk janë të paraqitura si vlerë e drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat e drejta të llogaritjes së aseteve dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në bilancin e gjendjes në vlerën e drejtë të tyre.

	Vlera ngritëse		Vlera e madhe	
	2010	2009	2010	2009
Asetet				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë	45,195	25,181	45,195	25,181
Të arkëtueshme tregtare dhe tjera	15,311	18,766	15,311	18,766
Të arkëtueshme financiare	2,196	60,605	2,196	60,605
Totali i aseteve	62,702	104,552	62,702	104,552
Detyrimet				
Të pagueshme tregtare dhe tjera	6,991	15,863	6,991	15,863
Totali i detyrimeve	6,991	15,863	6,991	15,863

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë realizuar me koston e amortizuar, më pak dispozita për dëmtimet. Për shkak të maturisë së tyre të shkurtër, vlera e tyre e drejtë korrespondon me vlerën që e mbajnë/vlerën llogaritëse.

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Vlera e drejtë e mjeteve monetare që përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat llogaritëse të tyre me përcaktim dhe për shkak të maturisë së tyre më pak se 3 muaj.

Te pagueshmet tregtare

Vlere llogaritëse e te pagueshmeve tregtare dhe te tjera eshte e perafert me vleren e tyre te drejte.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010

(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

4. LLOGARITJET DHE VLERËSIMET KONTABËL

Menaxhmenti ka diskutuar me Auditimin, Financat dhe komisionin e sigurimeve, një Komision Këshillëdhënës për Bordin e Drejtorëve të PTK Sh.A, mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shpalosjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit, si dhe vlerësimin dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë

Mungesë e marrëveshjes së interkoneksionit me Telekomin e Serbisë

PTK lidh thirrjet fikse ndërkombëtare me administratat e huaja nëpërmjet Beogradit në linjat fikse të menaxhuara nga Telekom i Serbisë. As në të kaluarën as tani nuk ka pasur kontrata formale mes PTK-së dhe Telekomit të Serbisë. Mungon një marrëveshje e interkoneksionit që do të rregullonte marrëdhëniet reciproke në lidhje me trafikun e telekomunikacionit.

Menaxhmenti i PTK-së e konsideron joreale të pritët çfarëdo lloj i zgjidhjes sa i përket trafikut mes Telekomit të Serbisë dhe PTK-së dhe, në vend të kësaj, e vlerëson si të mundshme që, pritjet e zhvillimeve të mëtutjeshme politike mes Kosovës dhe Serbisë, mund të marrin shumë vite para se të arrihet një marrëveshje e interkoneksionit mes të dy palëve.

Në mungesë të një marrëveshjeje zyrtare të interkoneksionit që do të përcaktonte tarifat për thirrjet në ardhje dhe në shkuarje për nga rrjeti '381', është jo praktikë që të matet vlera e trafikut për dhe nga rrjeti '381'. Megjithatë, është e matshme, që thirret në ardhje në zonat e rrjetit '381' në Kosovë ("thirrjet që mbarojnë në Kosovë") janë dukshëm më të larta sesa trafiku në shkuarje nga Kosova në jashtë vendit ("thirrjet në shkuarje"). Kjo tregon se nëse bëhet marrëveshja, do të jetë e mundur që të rriten të ardhurat neto në favor të PTK-së. Si një zgjidhje retrospektive janë konsideruar si jorealiste për momentin, këto pasqyre financiare që nuk reflektojnë ndonjë efekt financiar nga trafiku i tillë ndërkombëtar në lidhje me asetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Rikuperimi i llogarive dhe depozitave bankare

Deri në fund të vitit 2005, Banka Kreditore e Prishtinës, me të cilën Kompania kishte depozitat më 31 dhjetor 2005, hyri në pranueshmëri pas tërheqjes së licencës nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës me 13 mars 2006. Është bërë provizion për pasqyrat financiare për këtë vit dhe vitet paraprake për bilancet më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 respektivisht 12,492 mijë Euro dhe 12,502 mijë euro, pasi që një pasiguri e rëndësishme ekziston në rikuperimin e bilanceve me këtë bankë. Në vitin 2010, 10 mijë Euro (2009: 1,249 mijë Euro) janë kompensuar dhe njihen si të ardhura në përputhje me rrethanat.

Pasi që ende nuk është e mundur që të përcaktohet rezultati i procesit të likuidimit dhe shuma e depozitave të garantuara nga BPK, ekzistojnë pasiguritë e konsiderueshme në rikuperimin e bilanceve me këtë bankë. Prandaj, është siguruar një humbje e shkaktuar nga 100% të shumave të mbajtura me bankën. Nëse ka asete të mjaftueshme të likuidimit për të mbuluar pretendimet e kreditorëve, të ardhurat do të njihen në periudhat e ardhshme deri në shumën e përmirësuar.

Toka e përdorur nga Kompania

Menaxhmenti është i mendimit që disa ngastra toke konsiderohen si pronë e PTK-së në funksion të përdorimit të vazhdueshëm brenda përcaktimeve të pronësisë së Kosovës. Një vlerë nuk mund të zbatohet për këto asete në kohën e tashme. Në kohën e verifikimit të aseteve, ushtrimi i këtyre artikujve është përjashtuar, për shkak të pasigurisë së titullit ligjor.

Ndërtesat e përdorura nga Kompania

Gjatë verifikimit të aseteve, ushtrimi në periudhën para pronësisë së ndërtesave të caktuara, të identifikuar si në përdorim ose nën kontroll të PTK-së, nuk mund të përcaktohet, kryesisht për shkak të mungesës së qasjes ose mungesës së dokumentacionit të pronësisë. Një vlerë nuk mund të zbatohet për këto asete për momentin (në kohën e tashme).

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

4. LLOGARITJET DHE VLERËSIMET KONTABËL (vazhdim)

Burimet kryesore për pasigurinë e vleresimit (vazhdim)

Jetëgjatësia e asetëve

Përcaktimi i jetëgjatësisë së asetëve është bazuar në përvojën e kaluar me asete të ngjashme, si në faktorë të gjerë ekonomik ose industrial. Përshtatshmëria e jetëgjatësisë së vlerësuar është shqyrtuar çdo vit, ose sa herë që ka pasur një tregues të ndryshimeve të rëndësishme në supozimet përkatëse. Ne besojmë se vlerësimi kontabël në lidhje me përcaktimin e jetëgjatësisë së asetëve është një vlerësim i rëndësishëm i kontabilitetit pasi që përfshin vlerësimet në lidhje me zhvillimin teknologjik në një industri inovative. Pas kësaj kompania kishte bërë një vlerësim që jetëgjatësia e asetëve duhet të mbetet e njëjtë si vitin paraprak.

Inventari

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjatë përcaktimit të vlerës neto të realizueshme, janë marrë dëshmitë më objektive / të dhënat e disponueshme në bërjen e vlerësimeve.

Rikuperimi i llogarive të arkëtueshme

Ne kemi bërë llogaritjen e zhvlerësimit për llogaritë e dyshimta duke u bazuar në humbjet e vlerësuar që rrjedhin nga paaftësia e klientëve tanë për të bërë pagesat e kërkuara. Ne e bazojmë vlerësimin tonë në vjetrimin e bilancit të llogarive të arkëtueshme dhe përvojën e kaluar të zhvlerësimit, vlefshmërinë e kredisë të konsumatorëve, dhe ndryshimet në kushtet e pagesës të konsumatorëve tanë, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së humbjes nga shlyerja për llogaritë e dyshimta. Këto përfshijnë vlerësime në lidhje me sjelljen e konsumatorëve në të ardhmen dhe që rezultojnë me grumbullimet e parasë së gatshme në të ardhmen. Nëse gjendja financiare e klientëve tanë do të përkeqësohej, shlyerjet e tanishme të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa pritej dhe mund të tejkalojnë nivelin e humbjeve nga shlyerja, të njohura deri tani.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
5. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET

	<u>Toka dhe ndërtesat</u>	<u>Rrjeti Linjat</u>	<u>Makineria dhe pajisjet</u>	<u>Avanset për, dhe Investimet ne vijim</u>	<u>Totali</u>
<i>Kostoja /vlerësimi</i>					
Bilanci më 1 janar 2009	23,086	47,305	92,450	31,706	194,547
Shtesa	4	-	1,270	23,511	24,785
Transferime	<u>2,000</u>	<u>7,059</u>	<u>9,574</u>	<u>(18,633)</u>	<u>-</u>
Bilanci më 31 dhj. 2009	25,090	54,364	103,294	36,584	219,332
Bilanci më 1 janar 2010	25,090	54,364	103,294	36,584	219,332
Shtesa	267	12,804	26,810	(22,262)	17,619
Shlyerje	(40)	(227)	(19,981)	-	(20,248)
Transferime	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>(8,679)</u>	<u>(8,679)</u>
Më 31 dhjetor 2010	25,317	66,941	110,123	5,643	208,024
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>					
Bilanci më 1 janar 2009	(4,468)	(13,409)	(62,222)	-	(80,099)
Shpenzimi për periudhën	<u>(1,187)</u>	<u>(4,689)</u>	<u>(10,279)</u>	<u>-</u>	<u>(16,155)</u>
Bilanci më 31 dhj. 2009	(5,655)	(18,098)	(72,501)	-	(96,254)
Bilanci më 1 janar 2010	(5,655)	(18,098)	(72,501)	-	(96,254)
Shpenzimi për periudhën	(1,302)	(5,161)	(11,084)	-	(17,547)
Shlyerje	<u>40</u>	<u>227</u>	<u>19,981</u>	<u>-</u>	<u>20,248</u>
Më 31 dhjetor 2010	(6,917)	(23,032)	(63,604)	-	(93,553)
<i>Vlera bartëse</i>					
Më 1 janar 2009	18,618	33,896	30,228	31,706	114,448
Më 31 dhjetor 2009	19,435	36,266	30,793	36,584	123,078
Më 1 janar 2010	19,435	36,267	30,793	36,584	123,078
Më 31 dhjetor 2010	18,400	43,909	46,519	5,643	114,471

Shlyerja

Në përputhje me vendimet e datës 30 mars 2010 dhe 30 mars 2011, Kompania ka shlyer asetet që janë jashtë përdorimit. Kostoja e tyre dhe amortizimi i akumuluar është 20.248 mijë euro.

Shitja

Gjatë vitit 2010, Kompania ka shitur asetet e zhvlerësuara plotësisht dhe ka njohur të ardhura në vlerë prej 73 mijë euro (shih shënimin 18).

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

5. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET (vazhdim)

Humbjet nga dëmtimi në vlerë dhe rimarrja e mëvonshme

Kompania vazhdimisht merr ne konsiderate përparimet teknologjike mbi asetet fikse, duke rishikuar edhe funksionalitetin e qëndrueshmërinë e tyre në infrastrukturën ekzistuese. Në qoftë se ka ndonjë pajisje të dëmtuar apo të vjetruar, atëherë kryhet testi i dëmtimit në vlerë dhe pajisja ose humb vlerë ose del nga përdorimi.

Toka, ndërtesat dhe pajisjet nën ndërtim

Më 31 dhjetor 2010, paradhëniet për dhe investimet ne vijim përbëhen nga si vijon:

	2010	2009
-Ndërtimi i Rrjetit Mobil dhe BTS Pajisjete	2,671	20,718
-Rinovimi dhe zgjerimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i rrjeteve lokale të telefonisë fikse	2,425	11,949
-Paradhënie për Projektet për rrjetin mobil	137	322
-Paradhënie për Projektet për rrjetin fiks	30	-
-Të tjera	381	3,595
	5,643	36,584

Garancitë

Asnjë pronë, impiant apo pajisje nuk është dhënë si kolateral për ndonjë huazim.

Pronësia

Çështjet të pronësisë ekzistojnë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillim të administrimit të OKB-së në Kosovë në vitin 1999. Kjo paraqet një detyrim kontingjent të PTK-së që për momentin nuk është e kuantifikueshme. Zgjidhja e titullit është një element i instuticionalizimit të statusit final të Kosovës, ku PTK-ja nuk është palë.

Çështje tjera

Nuk ka asetë të siguruar nën kushtet e qirasë financiare.

Më 31 dhjetor 2010, asetet plotësisht të zhvlerësuar e kanë shumën prej 54,927 mijë Euro në kosto.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohej ndryshe)
6. ASETET E PATRUPËZUARA

	<u>Programet kompjuterike</u>	<u>Liçensat</u>	<u>Gjithsej</u>
<i>Kostoja</i>			
Bilanci më 1 janar 2009	19,922	9,759	29,681
Shtesa	5,301	-	5,301
Bilanci më 31 dhjetor 2009	25,223	9,759	34,982
Bilanci më 1 janar 2010	25,223	9,759	34,982
Transferimet	8,679	-	8,679
Shlyerje	(2,156)		(2,156)
Bilanci më 31 dhjetor 2010	31,746	9,759	41,505
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>			
Bilanci më 1 janar 2009	(11,083)	(2,937)	(14,020)
Shpenzimet për periudhën	(5,960)	(619)	(6,579)
Bilanci më 31 dhjetor 2009	(17,043)	(3,556)	(20,599)
Bilanci më 1 janar 2010	(17,043)	(3,556)	(20,599)
Shpenzimet për periudhën	(6,527)	(619)	(7,146)
Shlyerje	2,156		2,156
Bilanci më 31 dhjetor 2010	(21,414)	(4,175)	(25,589)
<i>Vlera bartëse</i>			
Më 1 janar 2009	8,839	6,822	15,661
Më 31 dhjetor 2009	8,180	6,203	14,383
Më 1 janar 2010	8,180	6,203	14,383
Më 31 dhjetor 2010	10,332	5,584	15,916

Programet kompjuterike ndërlidhen me koston e sistemit të faturimit dhe platformën e shërbimit të internetit.

Në vitin 2004 dy liçensa janë dhënë për 15 vite për të operuar me telekomunikacion përbrenda Kosovës, që përbëhen nga një liçensë e telefonisë mobile prej 6,500 mijë Euro dhe një të telefonisë fikse prej 2,900 mijë Euro.

Shlyerja

Në përputhje me vendimin e datës 30 mars 2010, Kompania ka shlyer asete të patrupëzuara me kosto dhe zhvlërësim të akumuluar në shumën prej 2,156 mijë euro.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
7. INVESTIMET E PERBASHKETA

Gjatë 2009, Kompania ka fituar interes në kapitalin e një kompanie të sapo krijuar të Operatorit Mobil 4 AL Sh.a., Shqipëri, për shumën e 2.400 mijë Euro. Investimi përbëhej nga para të gatshme të paguara. Në datën e gjendjes financiare, interesi i Kompanisë në entitetin e kompanisë të sapo krijuar është 30%.

Në Marrëveshjen midis aksionarëve të Operatorit Mobil 4 AL Sh.a., të bërë me datën 19 dhjetor 2009, është vërejtur se aksionarët e tjerë kanë mundësinë e propozimit për të blerë pjesëmarrjen e kompanisë për shumën e 120 mijë euro dhe 3% pjesëmarrje në ekuitetin total të Operatorit Mobil 4, që paraqet 240 mijë euro.

Në përputhje me Marrëveshjet ndërmjet aksionarëve, të datës 27 dhjetor 2010, ky opsion i blerjes është vënë në veprim dhe kompania ka marrë 120 mijë euro (shih shënimin 19) dhe pjesëmarrje në ekuitet në vlerë prej 240 mijë eurosh (shih shënimin 19).

Deri më 31 dhjetor 2010, pjesëmarrja në ekuitet është e përbërë prej 240,000 aksioneve të zakonshme me vlerë nominale prej € 1 për aksion.

Për shkak të shpjegimit më lart, nga 31 dhjetor 2010 Kompania ka riklasifikuar investimin e saj në ortakëri/bashkëpunëtorë në asetet financiare të disponueshme për shitje.

8. ASSETET FINANCIARE TË DISPONUESHME PËR SHITJE

Nga 31 dhjetor 2010, asetet financiare në dispozicion për shitje në vlerë prej 240 mijë Euro, kryesisht përbëhen nga investimi në 4 AL Sh.a, Shqipëri, siç shpjegohet në shënimin 7 Investime në ortakëri.

9. ASSETET E TAKSAVE TE SHTYRA DHE DETYRIMET

Njohja e Aseteve te Taksave te shtyra dhe Detyrimeve

Norma e tatimit e aplikueshme nga Kompania paraqet normën e detyrueshme të tatimit të korporatës që është 10%.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Asetet e tatimit të shtytë më 1 janar	2,564	2,988
Ndryshimi i njohur në pasqyrën e të ardhurave (shënimi 23)	(909)	(424)
Asetet e tatimit të shtyrë më 31 dhjetor	1,655	2,564

Asetet e Taksave te shtyra të njohura në bilanc të gjendjes ndërlidhen me diferencat e përkohshme ndërmjet bazës së llogaritjes dhe asaj tatimore të pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Asetet e taksave te shtyra te panjohura

Asetet e tatimit të shtyrë nuk janë njohur në lidhje me dëmtimin në vlerë të të arkëtueshmeve tregtare sepse nuk ka gjasa në këtë fazë që asetet e tilla do të përdoren në periudhat e ardhshme.

10. INVENTARI

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Kabllot dhe materialet e mirëmbajtjes.	5,967	7,660
Kartelat Sim dhe kartelat me gërvishtje	548	734
Artikujt postar	91	76
Inventari tjetër	279	222
	6,885	8,692

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

11. LLOGARITË E TË ARKËTUESHMEVE TREGTARE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Linjat fikse – personat fizik	17,402	16,638
Linjat fikse – kompanitë	19,166	18,457
Rrjeti i telefonisë mobile	10,872	10,182
Thirrjet në ardhje - vendore	1,917	4,375
Telefonatat hyrëse – Monaco Telecom International	3,185	2,703
Roaming – Monaco Telecom International	2,122	2,271
Shërbimet postare	753	696
Lizingu i fijeve optike	-	339
Shërbime të zërit	-	216
Llogari tjera të arkëtueshme	20	34
	<u>55,437</u>	<u>55,911</u>
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta	(40,126)	(37,145)
	<u>15,311</u>	<u>18,766</u>

Dispozita për dëmtim dhe para të humbura për shkak të mosgrumbullimit

Lëvizja në dëmtimin në vlerë për borxhet e dyshimta është përmbledhur si më poshtë:

	linja fikse	linja mobile	Posta	Totali
Bilanci i hapjes më 1 janar 2009	30,429	4,975	147	35,551
Rritja/(ulja)	(383)	2018	21	1,656
Çregjistrimi i borxheve të këqija	(62)	-	-	(62)
Bilanci i mbylljes më 31 dhjetor 2009	29,984	6,993	168	37,145
Bilanci i hapjes më 1 janar 2010	29,984	6,993	168	37,145
Rritja/(ulja)	595	1,044	47	1,686
Çregjistrimi i borxheve të këqija të shlyera më herët	1,295	-	-	1,295
Bilanci i mbylljes më 31 dhjetor 2010	31,874	8,037	215	40,126

Me 31 Dhjetor 2010, Kompania ka vlerësuar grumbullimin e të arkëtueshmeve, në bazë të të cilave ajo ka bërë shlyerjet për shkak të mosgrumbullimit të të arkëtueshmeve, që njihen si shpenzime korente në shumën prej 1.686 mijë euro (2009: 1.594 mijë euro) (shiko shënimin 22).

12. SHPENZIME TË PARAPAGUARA DHE TË ARKËTUESHME TË TJERA

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Shpenzime të parapaguara		
Avanset për sigurimin shëndetësor të punonjësve	4,018	3,341
Qiraja	294	565
Sigurimi	19	17
Parapagime tjera	277	490
Llogaritë tjera të arkëtueshme	410	214
	<u>5,018</u>	<u>4,627</u>

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

13. PARAJA E GATSHME DHE BILANCET BANKARE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Llogaritë rrjedhës në bankat lokale	22,502	13,934
Depozitat bankare me maturitet fillestar tre ose më pak muaj	22,010	10,604
Paraja e gatshme	683	635
Paraja në transit	-	8
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në pasqyrën e rrjedhës së parasë	45,195	25,181
Investimet afatshkurtëra financiare (depozitat bankare me maturitet 3 deri 12 muaj), përfshirë depozitat që kanë të bëjnë me letër-kreditë e përdorura	2,138	50,019
Investimet afatgjata financiare (depozitat bankare me maturitet mbi 12 muaj)	58	10,586
Paraja e gatshme dhe bilancet bankare	47,391	85,786

Depozitat bankare mirëmbahen në të gjitha bankat në Kosovë. Nuk ka llogari rrjedhëse ose investuese në bankat e huaja. Norma efektive e interesit e fituar nga depozitat bankare në vitin 2010, ndryshon mes 3,0% dhe 5,3% (2009: 2.0% deri 6.8%). Të hyrat nga interesi të fituara gjatë vitit 2010, arritën shumën prej 2,054 Euro (2009: 11,454 Euro).

Paraja në transit paraqet paranë e arkëtuar në pikat e shitjes dhe të depozituar në bankat përkatëse, që janë debituar në llogaritë bankare të Kompanisë pas datës së bilancit të gjendjes.

Bilancet e mëposhtme në banka janë paraqitur si neto të dëmtimit në vlerë të llogarive bankare në Bankën Kreditore të Prishtinës. Bilancet e mbetura me këtë bankë janë dëmtuar në vlerë në tërësi më 31 dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009.

Lëvizjet e llogarisë së zhvlerësimit për periudhën përkatëse janë si vijon:

	2010	2009
Më 01 Janar	12,502	13,751
Lëshimi	(10)	(1,249)
Më 31 Dhjetor	12,492	12,502

Depozitat e kufizuara për letrat e papërdorura të kreditit

Më 31 Dhjetor 2010, kompania ka të holla të kufizuara për letër kredit e porealizuara 421 mijë euro

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)

14. KAPITALI I AKSIONEVE, REZERVAT DHE FITIMET E MBAJTURA

Kapitali aksionar

Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/L-087), dhe bazuar në nenin 3 të këtij Ligji, ndërmarrjet publike duke përfshirë PTK Sh.A, janë deklaruar si pronë e Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka autoritetin ekskluziv për të ushtruar të drejtat e aksionarëve mbi NP-të.

Më 13 tetor 2009, statusi i kompanisë është ndryshuar dhe plotësuar: kapitali i themelor i lëshuar përmban 5 milion aksione Euro (pesë milion), i përbërë nga pesë milion aksione të zakonshme me vlerë nominale nga 1 (një) Euro për secilën. Të gjitha aksionet janë lëshuar në emër të Republikës së Kosovës.

Rezervat

Rezervat janë krijuar gjatë vitit 2009 me bashkimin e dy kompanive të PTK Holding dhe PTK sh.a., me vendim të Qeverisë për pjesën e alokimit të kapitalit të konsoliduar në rezerva në shumën prej 55,000 mijë euro.

Dividendët

Gjatë vitit 2010, Kompania ka deklaruar, në përputhje me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 7 maj 2010, dhe ka paguar plotësisht, për aksionarët, dividendën në shumën prej 80.000 mijë euro.

15. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Monaco Telecom International	979	730
Ipko	137	4,391
Furnitorë të tjerë	5,875	10,742
	6,991	15,863

16. AKRUALET DHE TË PAGUESHMET TJERA

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Shpërblimet ndaj punonjësve	2,382	1,818
Akrualët për shpenzimet e komisionit	1,712	3,463
Të pagueshmet e TVSH-së	974	231
Kontributet pensionale në fondin pensional të Kosovës	465	424
Të pagueshmet e tatimit në të ardhura personale	220	215
Të pagueshmet e pagave	77	85
Te pagueshmet e tatimit ne burim	20	26
Depozita sigurimi të marra nga konsumatorët	1	1
Te pagueshmet dhe tjera	212	79
	6,063	6,342

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
17. TË ARDHURAT E SHTYRA

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Kartat me gërvishtje të telefonisë mobile	2,376	2,896
Tarifat e telefonisë mobile të faturuara në avans	43	30
	2,419	2,926

Të ardhurat e shtyra për sa i përket kartave me gërvishtje ndërlidhen me pjesën e papërdorur në fund të vitit të kartave të shitura konsumatorëve të telefonisë mobile gjatë vitit.

18. TË ARDHURAT

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Të ardhurat e shërbimeve të telefonisë mobile	126,915	119,733
Të ardhurat e linjës fikse	18,677	19,505
Të ardhurat e shërbimeve të internetit	2,950	2,174
Të ardhurat e postës	2,075	1,959
Të ardhurat nga kabinat e telefonave publik	635	921
Të tjera	251	738
	151,503	145,030

19. TË HYRA TJERA

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Pjesëmarrje në kapitalin e kompanive të huaja	240	-
Kompensimi i marrë me shitjen e pjesëmarrjes në kapital	120	-
Fitimi nga shitja e pronës, ndërtesave dhe pajisjeve	73	-
Të hyra tjera	49	50
	482	50

20. SHPENZIMET OPERATIVE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Shpenzimet e rrjetit të telefonisë mobile	13,596	12,879
Komisionet për shërbimet e telefonisë mobile të ofruara nga MTI	2,998	2,389
Shërbimet publike	2,799	2,528
Shpenzimet e produkteve të shitura	2,415	2,530
Zbritjet në shitje	1,013	1,219
Shpenzimet e materialit për mirëmbajtje	948	962
Shpenzimet për IP komunikim	801	865
Shpenzimet e derivateve	616	811
Shpenzimet e trafikut ndërkombëtar/linjat e huazuara	562	631
Linjat satelitore dhe pajisjet	299	350
	26,047	25,164

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
21. SHPENZIMET E STAFIT

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Pagat	41,132	35,593
Pensioni i paguar direkt penzionerve	2	-
Kontributet pensionale – skema shtetërore	4,254	3,552
Kontributet për sigurim shëndetësor	1,883	1,438
	47,271	40,583

22. SHPENZIMET TJERA

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Marketingu	4,868	6,096
Mirëmbajtja dhe sigurim	3,434	4,630
Qeraja	2,257	2,100
Tarifat e liçensës, detyrimet doganore dhe tatimet	2,224	1,723
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta (shënimi 11)	1,686	1,594
Shpenzimet e zyrës dhe administrative	1,686	1,471
Shpenzimet për mjetet motorike	735	636
Shpenzimet e udhëtimit dhe trajnimit	726	1,018
Shërbimet për konsulencë	342	53
Të tjera	424	416
	18,382	19,737

Shpenzimet tjera përfshijnë tarifatat për shërbimet bankare, kostot e veturave, etj.

23. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT

Shpenzimi total i tatimit në të ardhura që është njohur në pasqyrën e të ardhurave përbëhet nga:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Shpenzimet aktuale të tatimit		
Periudha aktuale	3,351	4,764
Shpenzimi/(të ardhurat) e tatimit të shtyrë		
Prejardhja dhe anulimi i diferencave të përkohshme	909	424
Totali i shpenzimit të tatimit në pasqyrën e të ardhurave	4,260	5,188

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
23. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur marrëdhënia ndërmjet shpenzimit të tatimit mbi të ardhura në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe fitimit kontabël:

	<u>2010</u>			<u>2009</u>		
	Rregullimet e tatimit (EUR'000)	Tatimi efektiv* (%)	Tatimi (EUR'000)	Rregullimet e tatimit (EUR'000)	Tatimit efektiv* (%)	Tatimi (EUR'000)
Fitimi kontabël para tatimit	37,656			49,566		
Tatimi mbi të ardhura duke përdorur normën standarde të tatimit**		10%	3,766		10%	4,957
Shpenzimet e pazbritshme:						
- zhvlersimi dhe amortizimi	(9,093)	-2.4%	(909)	(4,459)	-0.9%	(446)
- dëmtimi në vlerë i borxheve të këqia	2,590	0.4%	168	1,656	0.3%	165
	(5)	0.0%	-		0.0%	-
- gjobat dhe dënime				1		
- shpenzimet tjera (jo-vendorët/kreditorët)	2,704	0.7%	270	3,503	0.7%	350
- akrualet e panjohura për qëllime tatimit	565	0.2%	56	(3,170)	-0.3%	(137)
- të ardhurat e patatueshme	(10)	0.0%	-	(1,256)	-0.2%	(125)
Efkti nga paraqita e : përfundimit të tatimit shtesë,tatimi i ri i korporatës mbi tatimi e shtyrë që është njohur		2%	909		1%	424
Totali i shpenzimit të tatimit mbi të ardhura në pasqyrën e të ardhurave		10.9%	4,260		10.5%	5,188

*Norma mesatare efektive e tatimit është shpenzimi/(e ardhura) në përpjesëtim me fitimin kontabël.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
23. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur harmonizimi i të arkëtueshmeve/pagueshmeve të tatimit të korporatës në datën e bilancit të gjendjes:

	2010	2009
	<hr/>	<hr/>
Tatimi mbi të ardhurat e korporatës arketueshem/pagueshem më 1 janar	3,646	3,108
Shpenzimi aktual i tatimit mbi të ardhurat	(3,351)	(4,764)
Pagesat e tatimit në të ardhurave të bërë gjatë vitit	<hr/> 498	<hr/> 5,302
Tatimi mbi të ardhurat e korporatës (i arkëtueshëm) më 31 Dhjetor	<hr/> 793	<hr/> 3,646

24. PALËT E NDËRLIDHURA

Në rrjedhën normale të biznesit, PTK kryen transaksione gjatë periudhave financiare raportuese me konsumatorët si UNMIK-u, entitet qeveritare dhe personat të cilët janë të ndërlidhur me këta. Kompania ka gjithashtu palë të ndërlidhura me drejtorët dhe zyrtarët ekzekutiv të tij. Transaksionet monetare me palët e ndërlidhura dhe drejtorët e zyrtarët ekzekutiv të tij kanë qenë vetëm në lidhje me pagesat e mëposhtme:

	2010	2009
	<hr/>	<hr/>
Kompensimet për drejtorët jo-ekzekutiv	198	192
Donacionet	-	466
Blerja e tokës përmes privatizimit	<hr/> -	<hr/> -
	<hr/> 198	<hr/> 658

25. ZOTIMET

Qeratë në pozitën e qiramarrësit

Qeratë operative të pashlyera të cilat janë si të pagueshme :

	2010	2009
	<hr/>	<hr/>
Më pak se një vit	732	1,462
Ndërmjet një dhe pesë viteve	628	609
Më shumë se pesë vite	<hr/> 356	<hr/> 206
	<hr/> 1,716	<hr/> 2,277

Pjesa më e madhe e qirave operative ndërlidhet me qiranë e ndërtesave administrative për operimet e PTK-së.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a.
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010
(në mijë Euro, pos nëse deklarohet ndryshe)
26. KONTINGJENTET

Seancat gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2010 seancat gjyqësore të ngritura kundër Kompanisë janë 19,214 mijë Euro. Në datën e bilancit të gjendjes të këtyre pasqyrave financiare, nuk ka provizione nga humbjet potenciale të regjistruara që kanë të bëjnë me seancat. Menaxhmenti i Kompanisë, në mënyrë të rregullt analizon rrezikun potencial që del nga humbjet me seancat gjyqësore, së bashku me seancat dhe të arkëtueshmet e mundshme me synim kundër Kompanisë, që mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet që gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk to të kenë si rezultat detyrime materiale.

Pronësia mbi pronën, impiantet dhe pajisjet

Shënimi 5, prona, impiantet dhe pajisjet, i referohet çështjeve të pronësisë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillimin e Administratës së OKB-së në Kosovë. Kjo paraqet një detyrim kontingjent për PTK-në i cili nuk është e mundur të kuantifikohet në këtë kohë.

Garancitë në favor të palëve të treta

Më 31 Dhjetor 2010, totali i garancioneve të lëshuara në favor të palëve të treta (kryesisht furnitorëve të PTK-së) janë 112 mijë Euro.

Zotimet kapitale

Nuk ka zotime madhore kapitale të kontraktuara në datën e bilancit të gjendjes të cilat tashmë nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

Rreziqet tatimore

Organet tatimore janë të duke vazhduar kontrollen tatimor për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi të ardhurat, tatimin në të ardhura personale dhe tatimin mbi qiranë, për periudhën nga 1 Janar - 31 Dhjetor 2010. Prandaj, detyrimet tatimore të kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara. Në këtë periudhë, nuk mund të përcaktohet një provizion për taksat dhe gjobat shtesë, nëse ka dhe nëse ato mund të vihen.

27. NGJARJET MBAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së deklaratës të pozicionit financiar para dhe gjatë lëshimit të këtyre deklaratave, në vazhdim janë ngjarjet me ndikim të rëndësishëm mbi operacionet e biznesit të Kompanisë:

Pas datës së deklaratës së pasqyrave financiare, më 30 Mars 2011 Bordi i Drejtorëve deklaroi një pagesë për dividendë në shumë prej 40 milion Euro.